




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Vendi: SHFMU – “Bajram Curri” – Krushë e Madhe, për buxhetin e vitit 2027.

Data: 29.07.2026, me fillim në orën 19:00.

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, Afrim Limani, Drejtori i Bujqësisë, Behar Thaqi, zyrtarët komunalë dhe anëtarët e grupit punues për buxhet.

Afrim Limani: Të nderuar banorë të fshatrave në Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë dhe ju pjesëmarrës. Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t’ju shpjegoj buxhetin komunal për vitin 2027. Sipas Qarkores së Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligjin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti të rëndësishëm, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000 € dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 € dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000 €. Në arsim: 634.305 € dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000 €. Në shëndetësi: 2.323.000 € dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000 €. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intensive. Në kategori ekonomike, përafërsisht buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000 €, mallra dhe shërbime 2.821.000 €, shpenzime komunal 440.000 €, subvencione 1.000.000 € dhe investime kapitale 4.523.000 €, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, krejt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar në ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit. Ju ftoj t’i paraqitni pyetjet dhe kërkesat e juaja rreth këtij dëgjimi publik.

Emrat	Kërkesat dhe idetë e qytetarëve
Muhamet Ramadani (Celinë)	Kanalizimi në rrugët fushore është një punë që dy vite ka mbetur peng dhe bujqit nuk mund të hyjnë në ara për të punuar, rastin e kemi pasur te korrje shirjet, por ka një mundësi që të bëhet një rrugë e re fushore. Gjithashtu edhe kanalizimet janë pa funksion në fshatin Celinë.
Afrim Dina (Celinë)	Kërkesë për Kanalizim – Tek pjesa poshtë hyrja prej fshatit Fortesë, janë afër 30 shtëpi që nuk kanë kanalizim.
Artan Zenuni (Krushë e Madhe)	Kërkojmë që të bëhet rregullimi i Lumit mes Krushës, i cili ka mbet i pa rregulluar që nga viti 2018; Rregullimi i rrugës për tek Drini i Bardhë së bashku me kanalizim; Rruga e varrezave për tu lidhur me lëndina;

	Kubëzimi i rrugëve ku nga viti 2020 kanë mbetur 4 rrugë të pa shtruara; Zona ekonomike- Plani rregullativ që pjesa e lëndinave të jetë si prioritet në vitin 2027.
Selami Hoti (Krushë e Madhe)	Arsimi- Kërkoj vendosjen e paneleve solare në shkollë për ruajtje të energjisë; Kuzhina brenda shkollës, që fëmijët të mos dalin në rrugë por të furnizohen me ushqim brenda në shkollë. Kanalizimi- mirëmbajtja, pastrimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; Kërkesë nga KRU "Gjakova" rruga nga Drini tek Hekurudha të kyçet kanalizimi me Ø 800. Infrastruktur- Kubëzimi i rrugëve të reja, që 8 vite nuk ka kubëzim të rrugëve të reja; Rregullimi/mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese, komasacioni/zona ekonomike. Bujqësia- Rrugët fushore, hapja/pastrimi i prrockave, sipërfaqe me sera, shpagimi i dëmeve, investimet nga jashtë komunës përmes granteve, subvencioneve. Fondacioni "Krusha" të aplikoj në grante të ndryshme, në staza afatgjate. Të bëhet kalendari i dëshmorëve nga fillimi i janarit dhe "Agro festa" të hyj në datat e komunës. Të bëhet pagesë për kryetarët e fshatrave. Shëndetësia- QMF-ja në Krushtë e Madhe punon në dy turne, mirëpo nuk ka stomatolog është hequr nga Krusha është dërguar në Rahovec dhe Autoambulanca nuk është.
Rrezart Veseli (Krushë e Madhe)	Kërkoj që të largohen asetet e pa përdorshme që gjenden jashtë shkollës. Kërkesë për tabela digjitale, pelet, letra dhe materiale për higjienë.
Nehar Shala (Krushë e Madhe)	Rregullimi i rrugës për te Drini i Bardhë dhe prrocka/Lumi në mes të Krushës.

Afrim Limani: Ju falënderoj të gjithëve për pyetjet dhe kërkesat tuaja. Të gjitha kërkesat janë të shkruara dhe të njëjtat do të shqyrtohen, gjithnjë duke u bazuar në kapacitetet buxhetore të komunës për vitin 2027. Nëse edhe dikush tjetër nuk ka pyetje, atëherë ju falënderoj edhe një herë.

Procesmbajtësi:


Alban Gashi